



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 129, Datë 31.05.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB – ENERGY”  
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENER GjISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; e ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/4 prot., datë 27.05.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e porcedurës për licencimin e shoqërisë “ALB-ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 101, datë 09.05.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 367, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “ALB - ENERGY” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017.
- Kjo vendimmarrje erdhi për arsye se ky aplikim nuk është paraqitur në afat, bazuar në përcaktimet e nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje shoqëria u njoftua me shkresën nr. 693/4 prot., datë 18.05.2022, iu bë me dije se në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ajo mund të paraqesë në ERE një aplikim të ri, tashmë për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit për mosfillim dhe dokumentacioni i paraqitur për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm edhe për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqërisë iu evidentua nevoja për të kryer edhe pagesën e diferencës që përkon me licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, prej 10,000 lekësh.
- Në përgjigje të sa më sipër shoqëria “ALB – ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 696/5 prot., datë 19.05.2022, ka përcjellë në ERE: Formatin e

Aplikimit të plotësuar tashmë për licencim dhe vërtetimin e kryerjes së diferencës së pagesës prej 10,000 lekësh.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”..
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike, Neni 9, pika 4.8, gërmat “b”, “c”. Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

**Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:**

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj.**
- **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). **Shoqëria duhet të depozitojë strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj.**

**Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8:**

- **gërmat “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve). **Shoqëria duhet të përcjellë sasi të që parashikon të tregtojë për vitet e ardhshme.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB-ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.